



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:273346  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05734086

**C.nr.3966/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në P., të cilin e përfaqëson B.G., zyrtare ligjore sipas autorizimit, kundër të paditurit Xh.I., Komuna P., baza juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seance me datën 24.05.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE**, me numër të lëndës Nd.nr.4../24 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë, me datën 20.05.2024, e lidhur në mes B... me seli në P., dhe të paditurit Xh.I., Komuna P., me bazë juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit përmbarues.

**A r s y e t i m**

Paditësi, nëpërmjet të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, me datë 08.12.2023 kundër të paditurit Xh.I., Komuna P., baza juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material.

Në qendrën e ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datë 20.05.2024.

Qendra për Ndërmjetësim, e ka njoftuar gjykatën se me datë 20.05.2024, palët ndërgjyqëse, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 426 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 15 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me datën 28.07.2018, pas shqyrtimit me datën 24.05.2024, ka ardhur në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbarimor, pra paraqet titullit përmbarues.

Numri i lëndës: 2023:273346  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05734086

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.3966/23, me datë 24.05.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.